



**Kompania Rajonale e Ujësjellësit
“Hidromorava” SH.A
Regional Company for Water
“Hidromorava” SH.A
Gjilan**

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, si dhe bazuar në konkursin publik të shpallur më datë 01.08.2022 për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv, ku është paraparë mundësia e vazhimit të mandatit pas përfundimit të mandatit fillestar, si dhe në përputhje me Statutin dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve i KRU “Hidromorava” Sh.A., në mbledhjen e shtatë të rregullt, mbajtur më datë 29.07.2025, pas vlerësimit të performancës së Kryeshefit Ekzekutiv, unanimisht merr këtë:

VENDIM


1. Kryeshefit Ekzekutiv të KRU “Hidromorava” Sh.A., z.Ymer Salihu, i vazhdohet mandati në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv edhe për një periudhë tre (3) vjeçare, që hyn në fuqi nga data 01.08.2025 dhe përfundon më 31.07.2028, me mundësi vazhdimi bazuar në vlerësimin e performancës së përgjithshme nga ana e Bordit të Drejtorëve.
2. Për zbatimin dhe formalizimin e këtij vendimi, ndërmerren të gjitha veprimet administrative përkatëse sipas procedurave të brendshme të ndërmarrjes.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga U.D Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

Arsyetim

Vendimi për vazhdimin e mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv është marrë pas një analize të thelluar të performancës së përgjithshme të Ndërmarrjes dhe të menaxhimit të saj gjatë periudhës së mandatit të parë.

Gjatë dy viteve të fundit, KRU “Hidromorava” Sh.A. ka pasur një performancë të qëndrueshme dhe pozitive, duke arritur rezultate të dukshme në përmirësimin e shërbimeve, stabilitetin financiar dhe menaxhimin efektiv të resurseve njerëzore dhe teknike. Udhëheqja nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv ka rezultuar në një funksionim më efikas të strukturës organizative, zbatim më të mirë të politikave strategjike dhe përmbushje të objektivave të planifikuara.

Bazuar në konkursin publik të shpallur me datë 01.08.2022, në të cilin ka qenë e paraparë që personi i emëruar në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv ka të drejtën e vazhimit të mandatit, Bordi i Drejtorëve, në bazë të vlerësimit të performancës së deritanishme, ka ushtruar të drejtën për zgjatjen e mandatit të tij, duke garantuar kështu kontinuitetin dhe stabilitetin në menaxhimin e ndërmarrjes.



U.D. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve


Z. Habil Zeqiri

